




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE DURRËS

NOTER ORNELA H. GURANJAKU
ADRESA Lagja "AQIF PASHA", Rruga
"28 NENTORI", PERBALLE ISH
GJYKATES - Elbasan
TEL: 697511079



KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(AKSIONE)

Nr. repertori: 1774

Nr. koleksioni: 889

Elbasan më 24/05/2024

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 11 fletë



A2024011120087413307





KONTRATË SHITJE E AKSIONEVE

Sec në datë 24/05/2024, para meje Notere ORNELA H. GURANJAKU, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Elbasan, Lagja "AQIF PASHA", Rruga "28 NENTORI", PERBALLE ISH GJYKATES - Elbasan, u paraqit personalisht:

SHITES: BASHKIA ELBASAN, me numër unik identifikimi të subjektit NUIS K52905207B, me adresë Elbasan, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Elbasan, **Gledian Llatja**, atësia Iljaz, amësia Fatmire, shtetas Shqiptar, lindur në Elbasan dhe banues në ELBASAN, me adresë Ymer Myzyri, lindur më 31/03/1981, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035692158 dhe nr. personal I10331053C, me autorizim nga **Asim Sula** atësia Dane, amësia Mustikale, shtetas Shqiptar, lindur në Luzaj, Berat dhe banues në ELBASAN, Lagjia "S,Dylgjeri", Kopeshti "7 Marsi", lindur më 17/04/1968, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035835118 dhe nr. personal G80417196V. referuar për efekt të kësaj kontrate si "Autoriteti Shitës",

BLERES: Shoqëria "BLAED TRADE" sh.p.k, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS K98423503J, me adresë Rruga 'bakaj', Magazine Me Nr. Pasurie 116/68, Zona Kadastrale Nr.3641, përfaqësuar nga Administratori Ilir Mustafaj, atësia Ali, amësia Hane, shtetas Shqiptar, lindur në Lezhë dhe banues në LEZHË, me adresë Kodra E Ades 03140042; Nd. 33; H. 1; Shëngjin; Ishull-Shëngjin; 4503; Lezhë, lindur më 24/12/1974, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034302630 dhe nr. personal H41224019L. referuar për efekt të kësaj kontrate si "Ofertuesi fitues" ose "Blerësi".

Informacion mbi palët dhe objektin e kontratës:

Bashkia Elbasan është zotëruese e vetme e aksioneve të shoqërisë tregtare sportive "Akademia e Futbollit Elbasan" sh.a me NIPT M13113202A, në masën 100%.

Këshilli Bashkiak nëpërmjet Vendimit Nr.118, date 30.11.2023, ka dhënë miratimin për shitjen me ankand të shoqërisë tregtare sportive "Akademia e Futbollit Elbasan" sh.a, në masën 70 %. Prefekti i Qarkut Elbasan, me shkresën 1325/1 date 15.12.2023 ka konfirmuar ligjshmeërinë e Vendimit të Keshillit Bashkiak Elbasan Nr.118, date 30.11.2023.

Autoriteti Shitjes, më dt.07.05.2024, shpalli fitues në procedurën e ankandit publik me objekt: "Shitje me ankand e 70% të aksioneve të shoqërisë tregtare sportive "Akademia e Futbollit Elbasan" sh.a në masën 70 (shtatëdhjetë)%, në vlerën **14.127.000** (katërmbëdhjetë milion e njëqind e njëzet e shtatë mijë) lekë, si oferte e kualifikuar me çmimin më të lartë të ofruar, ofertën e operatorit "BLAED TRADE" sh.p.k nr.NIPTI K98423503J

Shoqëria "BLAED TRADE" sh.p.k është person juridik, me objekt të aktivitetit tregtar, kryesisht n: *Tregti me shumicë e pakicë të mallrave industrial, ushqimore, pajisje elektrike dhe elektroshtepiake, hidraulike, ndërtimore, tregtim të makinerive e pajisjeve dhe pjesëve të këmbimit per pajisje dhe makineri, të lëndës së parë për gomisterinë. Tregtim mallrash per vete dhe te trete. Shitblerje automjetesh të ndryshme. Organizimi i eventeve sportive dhe komercializimi (marketingu aterialeve, pajisjeve sportive). Menaxhimin e të drejtave të imazhit të shoqërive sportive. Kujdestarinë (ruajtjen) shitblerjen, të drejtën për të marrë hua (huazim) dhe në përgjithësi negociimin e të drejtave sportive, federative e publicitare të sportistëve. Përfundimi i kontratave për*





A2024011120087413307

transferimin e lojtarëve si dhe shfrytëzimin e imazhit të lojtarëve. Shitblerjen e pasurive të lidhura me aktivitetin e karakterit sportiv të shoqërisë. Blerja, mbajtja, transferimi dhe shfrytëzimi i të drejtave objektive federative, të publicitetit, të drejtat e pronësisë dhe ekonomike të lidhura me performancën sportive të sportistëve. Këmbimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore në tokë bujqësore si dhe në sera. Trajtimi dhe tregtimi i produkteve të ndryshme bujqësore dhe ushqimore në ambientet frigoriferike.

Me ekzekutimin e kontratës së shitjes së aksioneve të shoqërisë tregtare sportive "Akademia e Futbollit Elbasan" sh.a, blerësi, shoqëria "BLAED TRADE" sh.p.k do të zotërojë 70% të aksioneve,

BAZA LIGJORE

- a) Ligji nr. 8417, date 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", te ndryshuar;
- b) Ligji nr.7850, date 29.07.1994 "Kodi Civil i RSH-se", i ndryshuar;
- c) Ligji Nr.9874, date 14.2.2008 "Per Ankandin Publik", i ndryshuar.
- d) Ligji Nr.9901, date 14.4.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar
- e) Ligji Nr.79/2017, "Per sportin ",
- j) Ligji nr.139/2015 "Per veteqeverisjen vendore ", i ndryshuar,
- g) Ligji nr.48/2014 "Per pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore e tregtare" i ndryshuar.
- h) Udhezimi nr.30 date 27.12.2011"Per menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit publik"
- i) Statuti i shoqerise, dt. 21.06.2021.
- j) Ligji nr. 110, date 20.12.2018 "Per Noterine".

Neni 1

Perkufizime

- **"Kontratë"** do te thote marreveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit shites dhe ofertuesit fitues qe perbehet nga dokumentat e ankandit duke perfshire KPK dhe KVK, te gjitha bashkangjitjet dhe formularet e plotesuar dhe te gjitha dokumentat e tjera qe perfshihen ne referimin e çdo dokumenti.
- **"Pale (t)"** do te thote nenshkruerit e kontrates.
- "Autoriteti shites" do te thote Autoriteti Kontraktor qe eshte pjese e kesaj kontrate dhe sipas dispozitave te kesaj kontrate shet Mallrat (aksionet). Ky term kudo qe perdoret ka kuptim te njejte me ate te perkufizuar ne ligj.
- **"Ofertues fitues"** do te thote personi fizik ose juridik qe eshte pale e kesaj kontrate dhe sipas dispozitave te kesaj kontrate blen Mallrat (aksionet).
- **"Objekt i kontratës"** do te thote te gjitha Mallrat dhe Sherbimet ne Lidhje me to qe Autoriteti shites do te siguroje sipas kushteve te kontrates.
- **"Çmim kontrate"** do te thote çmimi qe i paguhet autoritetit shites sipas kontrates per zbatimin e plote dhe te perpikete te detyrimeve te tij kontraktore.
- **"Llogaritë"** do te thote pasqyrat financiare te kontrolluara te shoqerise, te pergatitura ne perputhje me parimet e pergjithshme te kontabilitetit te pranuar ne Shqiperi, per vitin ushtrimor ne daten e fundit kontabel.
- **"Mbyllja"** do të thotë finalizimi i shitjes dhe blerjes se aksioneve sipas kësaj kontrate, si rrjedhojë e përmbushjes nga palet e detyrimeve te tyre respektive.
- **"Data e mbylljes"** do të jetë data e përcaktuar në nenin 5 të kontratës.
- **"Dëm"** i referohet çdo demi financiar te shkaktuar nga palet si pasoje e drejtperdrejte e shkeljes se nje deklarimi dhe/apo garancie, perfshire ketu shpenzimet e arsyeshme te kryera ne perpjekje per te parandaluar apo pakesuar demin.





A2024011120087413307

• **"Legjislacion"** do të thote çdo akt normativ kombëtar apo lokal, urdher, dekret apo ligj tjetër (përfshirë legjislacionin për mjedisin) rregullore ose statut apo çdo rregull, kod, direktive apo çdo licencë, aprovim, leje apo autorizim apo miratime të tjera në fuqi, të Republikës së Shqipërisë apo të çdo njesie apo ndarjeje administrative ose të çdo personi të krijuar me ligj (qoftë apo jo autonom), që ka juridiksionin përkatës, për sa kohë që është publikuar apo publikisht i aksesueshëm, dhe subjekt i vendimeve të gjykatave dhe trupave gjyqësive të ndryshme të Republikës së Shqipërisë, vendimeve dhe akteve të ministrave, qarkullore të departamenteve, si dhe deklaratat dhe interpretimet e organeve zyrtare të Republikës së Shqipërisë që kanë juridiksion mbijetësues në fjalë; përfshirë ndryshimet e herëpashërshme të tyre.

• **"Periudha para mbylljes"** do të thote periudha nga data e nënshkrimit, përfshirë këto date, deri në datën e mbylljes, përfshirë këto date.

• **"Data e nënshkrimit"** do të thote dita në të cilën është nënshkruar kjo marrëveshje nga të dy, blerësi dhe shitësi, siç paraqitet në faqet e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

• **"Taksat" apo "tatimi"** do të thote të gjitha llojet e barrës fiskale dhe të taksave në Shqipëri, tarifave doganore dhe detyrimeve të tjera të natyrës fiskale, përfshirë interesat, gjobat apo detyrimet e tjera të lidhura, të pagueshme ndaj apo të ngarkuara nga një autoritet tatimor, doganor etj., si dhe të gjitha kontributet për sigurimet shoqërore dhe kontributet e detyrueshme për sigurimet shëndetësore.

Neni 2

Objekti i kontratës

Objekt i kësaj kontrate është kalimi i së drejtës së pronësisë së 70 (shtatëdhjetë)% të aksioneve të shoqërisë tregtare sportive **"Akademia e Futbollit Elbasan" sh.a**, me nr. NIPT **M13113202A**, në favor të shoqërisë: **"BLAED TRADE" sh.p.k** nr. NIPTI **K98423503J**, përkundrejt pagimit të çmimit të kontratës.

Neni 3

Blerja e aksioneve në shitje

3.1. Sipas kushteve dhe afateve të kësaj kontrate, në datën e mbylljes, shitësi do t'i shëse blerësit aksionet duke i dhënë garanci të plotë për titullin dhe blerësi do të blejë nga shitësi aksionet në shitje dhe çdo të drejtë që lidhet me to, të lira nga çdo barrë, me një vlerë të barabartë me shumën e percaktuar në nenin 4 dhe të pagueshme, sipas mënyrës që përcaktohet po aty.

3.2. Mbyllja e transaksionit që parashikohet në këtë kontratë e që do të kryhet në datën e mbylljes do të zhvillohet pranë zyrave të shitësit.

Neni 4

Çmimi i blerjes dhe mënyra e pagesës

4.1. Çmimi total i blerjes së 70 (shtatëdhjetë)% të aksioneve në shitje të shoqërisë tregtare sportive **"Akademia e Futbollit Elbasan" sh.a** me nr. NIPT **M13113202A** është **14.127.000 (katërmëdhjetë milion e njëqind e njëzet e shtatë mijë) lekë**.

4.2. Blerësi, brenda 20 (njëzet) ditëve nga nënshkrimi i kësaj kontrate, duhet që të transferojë shumën në llogarinë e Bashkisë Elbasan, sipas faturës për arkëtim bashkangjitur kësaj kontrate.

4.3. Dega Thesarit Elbasan 0808 Bashkia Elbasan 2109001





A202401112008*41330*

Kodi ekonomik: 1166100 (Shitja e titujve të pjesëmarrjes në ndërmarrjet shtetërore) (në çdo banke të nivelit të dytë).

- 4.4. Palet kanë rënë dakord që afati për likuidimin e çmimit të shitjes do të jetë brenda **20 (njëzetë) ditëve** nga nënshkrimi nga palët e kësaj kontrate.
- 4.5. Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagese paraprake, duhet të paguhet në kohë siç specifikohet në kontratë.
- 4.6. Pagesa duhet bërë në monedhën shqiptare (LEK-ALL).
- 4.7. Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhirohen në llogarinë e Autoritetit Shitës (Bashkia Elbasan).

Neni 5

Nënshkrimi i kontratës dhe mbyllja (finalizimi i shitjes)

- 5.1. Menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, çdo pale do të fillojë veprimet përgatitore për të organizuar rregullisht mbylljen e transaksionit dhe për të përmbushur të gjitha kushtet paraprake që parashikohen në këtë kontratë. Palët bien dakord që kjo kontratë është një marrëveshje me kusht dhe kushti është ndodhja e mbylljes (finalizimi i shitjes së aksioneve).
- 5.2. Mbyllja do të realizohet, pranë zyrave të Bashkisë Elbasan, në datën që fondet xhirohen (kreditohehen) në llogarinë e Bashkisë Elbasan.
- 5.3. Në datën e mbylljes:
- Shitësi do të kryejë këto veprime:
 - Do të dorëzojë me procesverbal aksionet në shitje, i cili do të nënshkruhet nga të dy palët.
 - Do të nënshkruajë dhe do të dorëzojë dhe/ose do të bëjë të mundur nënshkrimin dhe dorëzimin e dokumenteve të tjera të nevojshme sipas legjislacionit shqiptar, në mënyrë që t'i kalojë blerësit një titull të mirë dhe të tregtueshem mbi aksionet në shitje dhe për të përmbushur siç duhet qëllimin e kësaj kontrate, përfshirë noterizimin e saj;
 - Blerësi do t'i dorëzojë shitësit dokumentet e mëposhtme:
 - Dokumentin e pagesës së çmimit të blerjes, në shumën e përcaktuar në nenin 4;
 - Një kopje origjinale të vendimit të organeve kompetente të blerësit, që miraton blerjen e aksioneve në shitje (Vendim i Asamblesë së Ortakëve që miraton blerjen);
- 5.4. Blerësi do të sigurojë që të jenë marrë të gjitha vendimet e organeve kompetente të saj të nevojshme për të ndermarre detyrimet e parashikuara në këtë kontratë, me qëllim ekzekutimin dhe zbatimin e transaksionit.
- 5.5. Në datën e mbylljes, blerësi do të fitojë titullin mbi aksionet në shitje dhe shitësi po në këtë datë do të regjistrojë blerësin në regjistrin e aksioneve të shoqërisë. Blerësi do të përfitojë çdo dividend të deklaruar ose të paguar, si dhe do të gezojë të gjitha të drejtat e tjera që lidhen me to, duke filluar nga data e mbylljes.
- 5.6. Kur të kryhet mbyllja, të gjitha veprimet e mbylljes do të konsiderohen se kanë ndodhur në të njëjtën kohë në datën e mbylljes dhe asnjë transferim ose dorëzim nuk do të quhet i përfunduar derisa të gjitha veprimet e mbylljes të kenë përfunduar, siç parashikohet në këtë nen.





A2024011120087413307

Neni 6

Deklarimet dhe garancitë e shitësit

6.1. Shitësi deklaron dhe garanton se ka vënë në dispozicion të gjithë informacionin përkatës për shoqërinë për qëllimet e transaksionit. Shitësi, gjithashtu, garanton se çdo garanci dhe deklaram do të jetë i vërtetë, i saktë dhe jo i keqperdorur në datën e mbylljes.

6.2. Shitësi, me anë të kësaj kontrate, deklaron dhe garanton në lidhje me shoqërinë, si dhe me transaksionin që parashikohet në këtë kontrate, deri në datën e nënshkrimit të saj, për të gjitha çështjet që vijojnë:

i. Organizimi

Shoqëria "Akademia e Futbollit Elbasan" sh.a është një shoqëri e krijuar dhe e themeluar rregullisht sipas ligjeve shqiptare.

ii. Autorizimi

Të gjitha procedurat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar, që duhet të ndërrerren nga ose për llogari të shitësit dhe që autorizojnë shitësin të lidhë dhe të zbatojë këto kontrate janë kryer rregullisht: kjo kontrate është nënshkruar dhe dorëzuar rregullisht nga shitësi dhe përben një detyrim të vlefshëm dhe ekzekutiv për shitësin dhe që duhet zbatuar prej tij, në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj kontrate.

iii. Mungesa e konflikteve.

Nënshkrimi dhe dorëzimi i kësaj kontrate, si dhe perfundimi i transaksionit që parashikohet në këtë kontrate dhe përmbushja e kushteve, afateve dhe dispozitave të kësaj kontrate nga shitësi nuk janë dhe nuk do të jenë në konflikt ose nuk do të rezultojnë në ndonjë shkelje apo mospërmbushje ose nuk do të mundësojnë krijimin e ndonjë të drejte për perfundimin, anulimin, ose përshpejtimin e ndonjë detyrimi, ose humbjeje të ndonjë përfitimi material, ose nuk do të krijojnë ndonjë barre mbi çdo aktivitet, aset ose pronë të shitësit, sipas dispozitave të një vendimi gjyqësor, urdhri, dekreti, rregulli ose rregulloreje të detyrueshme për shitësin.

iv. Pronësia.

Shitësi është pronari dhe përfituesi i vetem dhe i ligjshëm i aksioneve në shitje, në një total prej 70% (shtatëdhjetë përqind) të aksioneve, dhe deklaron dhe garanton si aksionari i vetem i shoqërisë se shoqëria është pronari dhe përfituesi i vetem dhe i ligjshëm i të gjitha aksioneve që përbejnë kapitalin.

Aksionet në shitje janë të percaktuara dhe të emertuara rregullisht, si dhe janë paguar plotësisht. Aksionet në shitje janë të lira dhe të çliruara nga çdo barre e çfaredolloji dhe shitësi ka të gjitha të drejtat, kompetencën dhe autorizimin e plotë për t'i shitur, për t'i kaluar, për t'i transferuar dhe për t'i dorëzuar aksionet në shitje në përputhje me afatet e kësaj kontrate.

Nuk ka asnjë kontrate, marrëveshje ose detyrim që krijon ose vendos ndonjë barre në lidhje me aksionet në shitje, ose ndonjë numer aksionesh të autorizuara, por të paemertuara në kapitalin e shoqërisë. Asnjë person nuk pretendon se ka ndonjë të drejte mbi ndonjë barre lidhur me ndonjë nga aksionet në shitje.

Perveç kësaj kontrate, nuk ka asnjë kontrate, marrëveshje ose detyrim që parashikon krijimin, dhenien, emetimin, transferimin, riblerjen ose ripagimin, ose dhenien e se drejtes një personi (të kushtëzuar ose jo) për të kërkuar dhenien, emetimin, transferimin, riblerjen ose ripagimin e ndonjë aksioni të kapitalit të shoqërisë (që përfshin, por pa u kufizuar në një preferencë, të drejtën për të ofruar i pari ose të drejtën e parablerjes ose kembim).





A202401112008741330

Me nënshkrimin e kësaj kontrate nga palet dhe pagesën e plote të çmimit të kontratës, ofertuesi fitues, blerësi detyrohet menjëherë të kryejë të gjitha procedurat ligjore për regjistrimin e kësaj kontrate në Qendren Kombëtare të Biznesit për ndryshimin e pronësive mbi aksionet, përfaqësuesit ligjorë, seline si dhe detajet e kontaktit.

v. Llogaritë.

Llogaritë e shoqërisë të datës së fundit kontabel që i janë vënë në dispozicion, blerësit dhe që janë përgatitur në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me parimet e përgjithshme të kontabilitetit të pranuar në Shqipëri.

vi. Regjistrat kontabël dhe libra të tjerë të shoqërisë.

Regjistrat kontabël dhe libra të shoqërisë janë të azhurnuar, nën zotërim ose nën kontrollin e shoqërisë dhe mbahen në mënyrë të duhur dhe të gjitha regjistrat dhe libra kontabel janë mbajtur rregullisht dhe në përputhje me ligjet shqiptare dhe me standardet, parimet dhe praktikën e zbatueshme të vendit.

vii. Mungesa e ndryshimeve materiale

Aktiviteti i shoqërisë është zhvilluar normalisht në mënyrë që të mbahet si një aktivitet i vazhdueshëm; dhe nuk ka ndodhur asnjë ndryshim material (thelbsor), në përbajtjen, strukturën dhe vlerën e aseteve, si dhe të detyrimeve siç tregohet në llogaritë, si dhe nuk ka ndodhur asnjë zbritje materiale e vlerës së aktiveve neto të trupezuara të shoqërisë (përveç; rastit të amortizimit të zakonshëm dhe të zhvleresimit), në bazë të vleresimit të përdorur në llogaritë. Që nga data e fundit kontabel, shoqëria është administruar dhe ka funksionuar në mënyrë të duhur dhe shoqëria: nuk ka lidhur asnjë marrëveshje; ose nuk i është ngarkuar asnjë detyrim material, nuk ka pesuar asnjë përgjegjësi materiale ose ndryshim material përkeqësues; ose nuk ka ndërmarrë asnjë veprim tjetër, i cili mund të shkaktojë që ndonjëri prej deklarimeve dhe garancive të shitesit që parashikohet në këtë kontratë, të bëhet e pavërtetë ose e parregullt.

vii. Shoqëria "Akademia e Futbollit Elbasan" sh.a, që nga data e fundit kontabël:

- a) nuk ka pesuar ndonjë ndryshim material përkeqësues lidhur me asetet, pronat ose aktivitetet e saj të biznesit;
- b) nuk ka pesuar asnjë ngjarje ose rrethana materiale në lidhje me asetet, biznesin ose pronat që rrezikon materialisht, të ndërprejë, të pengojë, të demtojë ose përndryshe të cenojë materialisht dhe në mënyrë përkeqësuese rezultatin e veprimtarisë së saj në teresi;
- c) nuk ka nënshkruar asnjë transaksion ose kontratë, ose hapur ndonjë procedurë prokurimi;
- d) nuk ka shitur, transferuar, vënë peng, dhënë me qira ose përndryshe disponuar ndonjë aset ose pronë që zotëron shoqëria;
- e) nuk ka përdorur personel ose nuk kanë rritur shkallën e kompensimit të pagueshëm ose për t'u paguar ndaj punonjësve, përveç rritjes sipas praktikave të mëparshme dhe në përputhje me çdo shpërblim aktual ose me plane të tjera, ose nuk kanë ndryshuar organizimin e punës në ndonjë mënyrë materiale;
- f) nuk ka fituar ose marrë me qira ndonjë pasuri të paluajtshme ose nuk ka bërë ndonjë shpenzim kapitali të trupezuar ose të patrupezuar, përveç kontratës së qirës së zyrave;





A202401112008741330

- g) nuk ka fituar ose disponuar, ne çfaredolloj forme, interesa ne kapitalin e shoqerive te tjera ose nuk ka fituar, disponuar ose hyre ne marredhenie qiraje (si qiramarres ose qiradhenes) per ndonje aktivitet apo per ndonje pjese te aktivitetit;
- h) nuk ka marritur ose shtuar, ndonje detyrim ne lidhje me ndonje garanci ose demshperblim, ose tjetër jashte zhvillimit normal te aktivitetit te saj;
- i) nuk ka vonuar pagesa, ndryshuar fatura dhe ristrukturuar pagesa, ose kushtet e pagesave apo te tjera, ndryshe nga praktikat e meparshme te zbatueshme te biznesit;
- j) nuk ka paguar, likuiduar apo penbushur ndonje pretendim, pergjegjesi ose detyrim jashte ushtrimit normal te biznesit te saj;

viii. Taksa dhe deklaratat fiskale.

Shoqeria ka depozituar ne kohen e duhur te gjitha deklaratat periodike dhe vjetore fiskale qe parashikohen nga legjislacioni fiskal i zbatueshem ne lidhje me to.

ix. Aktivet afatshkurtra

Shoqeria ka titull pronesisë te plote, te mire, te regjistruar dhe te tregtueshem mbi te gjitha aktivet afatshkurtra, qe pasqyrohen ne llogarite e dates se fundit kontabel.

x. Çështjet gjyqesore

Shitësi garanton që deri në momentin e nënshkrimit të kontratës nuk ka dhe nuk është në dijeni të ndonjë pretendimi tjetër te paleve të treta që është ne proces gjyqësor dhe/ose arbitrazhi apo që rrezikon të ngrihet ndaj shoqërisë **“Akademia e Futbollit Elbasan” sh.a**

Neni 7

Deklarimet dhe garancitë e blerësit

Blerësi bën deklarime dhe i jep garancitë e mëposhtme shitësit dhe secila prej tyre do të jetë e vërtetë dhe e saktë në datën e mbylljes:

7.1. Shoqeria “BLAED TRADE” sh.p.k është një shoqëri e themeluar dhe e organizuar rregullisht dhe që ushtron veprimtarinë e tij, sipas së drejtës së Republikës së Shqipërisë, nuk është në gjendje paafesie paguese dhe ka kompetenca dhe autoritet të plote të kryejë aktivitetin e tij, sic e kryen aktualisht dhe të zoterojë asetet dhe pronat e tij, siç i zoteron aktualisht.

7.2. Organizimi: Përmirësimi i strukturës aktuale të Klubit, me qëllim arritjen e rezultateve sa më të larta në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

7.3. Autorizimi: Te gjitha aktet e shoqërisë dhe/ose procedurat e tjera që duhet të ndermerren nga ose për llogari të blerësit që autorizojnë blerësin të lidhë dhe të zbatojë këto kontrate janë ndermarre rregullisht, kjo kontratë është nënshkruar dhe dorëzuar nga blerësi në mënyrën e duhur dhe përben një detyrim të vlefshëm dhe ekzekutiv ndaj tij, në përputhje me afatet dhe kushtet e saj.

7.4. Ruajtja e selisë ligjore: Blerësi do të ruajë selinë ligjore të shoqërisë.

7.5. Investimet dhe plani biznesi: Blerësi do të ndërmarrë të gjithë veprimet për të zhvilluar aktivitetet e shoqërisë, me qëllim që ta bëjë këtë biznes konkurrues dhe efikas në treg, në përputhje me planin e tij të biznesit.





A202401112008741330

Neni 8

Premtime të përbashkëta të palëve

- 8.1. Palët heqin dorë nga çdo veprim dhe do të njoftojnë njëra-tjetrën menjëherë për çdo zhvillim, i cili mund të rrezikojë apo të vonojë përfundimin e transaksionit.
- 8.2. Palët do të ndihmojnë njëra-tjetrën në mënyrë të arsyeshme me qëllim që të përmbushin kushtet paraprake të parashikuara në këtë kontratë.
- 8.3. Shitësi do të bashkepusojë dhe do të mundesojë që shoqëria të bashkepusojë me blerësin, ose të veprojë direkt, kur është e nevojshme apo sipas kërkesave të legjislacionit të zbatueshëm, për të përgatitur depozitimet që kërkohen, pranë organeve kompetente, dhe do të mundesojë që shoqëria t'i sigurojë blerësit dokumentet dhe informacionin, të nevojshëm për qëllimet e depozitimit.
- 8.4. Palët bien dakord që të kontrollojnë së bashku përmbushjen e të gjitha kushteve të mbylljes.

Neni 9

Forca madhore

- 9.1. Mospermbushja e detyrimeve sipas kesaj kontrate prej njerës nga palet, nuk dote quhet shkelje ose mospermbushje e kesaj kontrate, ne rast se kjo mospermbushje vjen si pasoje e nje force madhore, referuar legjislacionit ne fuqi, me kusht qe pala e prekur nga kjo ngjarje: a) te kete marre te gjitha masat paraprake te arsyeshme, perkujdesjen e duhur dhe masa te ndryshme te arsyeshme, per te permbushur afatet dhe kushtet e kesaj kontrate, dhe b) te kete njoftuar palen tjetër sa me shpejt te jete e mundur per kete ngjarje.
- 9.2. Çdo periudhe, brenda se ciles njera nga palet sipas kesaj kontrate duhet te kryeje nje veprim ose detyre, do te zgjatet per nje periudhe kohe te barabarte me periudhen, gjate se ciles kjo pale nuk mund te kryeje kete veprim per shkak te forces madhore.

Neni 10

Zgjidhja e kontrates

Kjo kontratë përfundon kur palët nuk kanë përmbushur detyrimet sipas kushteve dhe afateve të përshkruara në kontratë dhe veçanërisht kur:

- (i) Ofertuesi fitues (blerësi) deshton të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontrates sipas kushteve dhe afatit të percaktuar. Ne kete rast Autoriteti shitës duhet t'i japi Ofertuesit fitues njoftim me shkrim per nderprerjen per mosplotesim dhe t'i japi Ofertuesit 15 dite te ndreqe mosplotesimin me perjashtim kur nderprerja eshte bere per veprime korruptive ose te paligjshme, rast ne te cilin nderprerja do te jete e menjehershme.
- (ii) Ofertuesi fitues falimenton ose behet i paafte te paguaje. Ne kete rast Autoriteti shitës duhet t'i japi ofertuesit fitues njoftim me shkrim per nderprerjen.

RESEARCH
AND
DEVELOPMENT
SECTION



A20240111200841330

Neni 11

Ligji i zbatueshëm dhe juridiksioni

- 11.1. Kjo kontrate, rregullohet nga ligji shqiptar.
- 11.2. Çdo mosmarreveshje, që lind në lidhje me vlefshmerine, fuqine, interpretimin, zbatimin e detyrueshem dhe zgjidhjen e kesaj kontrate, do te zgjidhet me mirekuptim, ne te kundert kompetente eshte Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Neni 12

Ndryshimi i kontratës dhe njoftimet midis palëve

12.1. Ndryshimet e kontratës.

- i. Çdo shtese, ndryshim, zgjidhje ose heqje dore nga ndonje prej dispozitave te kesaj kontrate, do te jete e vlefshme vetem ne qofte se behet me shkrim dhe nenshkruhet nga ose ne emer te seciles pale.
- ii. Mosushtrimi ose vonesa ne ushtrimin e nje te drejte ose mase mbrojtjeje, qe parashikohen ne kete kontrate ose nga ligji, nuk perben heqje dore nga e drejta ose masa e mbrojtjes, ose heqje dore nga te drejta ose masa te tjera mbrojtjeje.
- iii. Mosushtrimi i vetem ose i pjesshem i nje te drejte ose mase mbrojtjeje qe parashikohen ne kete kontrate ose nga ligji, nuk pengon ushtrimin e metejshem te se drejtes ose mases mbrojttese ose ushtrimin e nje te drejte ose mase tjeter mbrojtese.

12.2 Njoftimet midis palëve.

- i. Njoftimet ose komunikime te tjera sipas ose ne lidhje me kete kontrate (njoftimi), do te jene:
- me shkrim;
 - ne gjuhen shqipe;
 - do t'i dorezohen ose dergohen me email ose/dhe me poste rekomande, pales qe duhet te marre njoftimin ne adresen e caktuar ketu me poshte, ose ne nje adrese tjetere te specifikuar nga kjo pale.
- ii. Adresat e njoftimit jane:

Blerësi

- Emri i pales: Shoqeria "BLAED TRADE" sh.p.k
- Adresa: Lezhe Zejmen TRESH Rruga "Bakaj", Magazine me nr.pasurie 116/68 zona kadastrale nr.3641

Shitësi

- Emri i pales: Bashkia Elbasan
- Adresa: Lagjja "11 Nëntori", rruga "Qemal Stafa"

Neni 13

Të ndryshme

- 13.1. Te gjitha shpenzimet noteriale per nenshkrimin dhe zbatimin e kesaj kontrate do te paguhen nga bleresi.





13.2. Kjo kontrate, se bashku me shtojcat bashkelidhur, perben marreveshjen e plote dhe zevendeson cdo marreveshje te meparshme (nese ka) midis paleve qe lidhet me objektin e kesaj kontrate.

Neni 14 Shtojcat

- 14.1. Shtojcat e meposhtme qe i jane bashkengjitur kesaj marreveshjeje do te quhen si pjese perberese e saj
- i. Shtojca A: Raporti i vleresimit te ekspertit kontabël mbi llogaritë e shoqerisë "Akademia e Futbollit" Elbasan sh.a, hartuar në momentin para ankandit dhe miratuar me vendimin Nr.118, datë 30.11.2023 të Këshillit Bashkiak.
 - ii. Shtojca B: Plani i biznesit i blerësit paraqitur në procedurën e ankandit.
 - iii. Shtojca C: Formulari i ofertës paraqitur në ankand.
 - iv. Shtojca D: Kushtet e përgjithshme të kontratës (KPK) pjesë e dokumentave të ankandit.
- 14.2. Per te shmangur cdo dyshim, shitësi dhe blerësi garantojnë dhe deklarojnë se përmbajtja e shtojcave te mesiperme eshte e vertete dhe e sakte dhe do te jete e tille dhe ne daten e mbylljes.

Neni 15 Dispozitat perfundimtare

15.1. Kontrata e Shitjes te Aksioneve u lexua nga une Noterja me ze te larte dhe ne menyre te qarte ne prani te Paleve kontraktuese; te cilet me deklaruan see kuptuan permbajtjen e saj dhe meqenese shprehin vullnetin e tyre te lire e te plote, u njohen dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nenshkruajne ate rregullisht perpara meje Noteres.

15.2. Une Noterja, verifikova identitetin e paleve nepermjet dokumenteve te identitetit dhe pasi e gjeta permbajtjen e aktit noterial te mesiperme, ne perputhje te plote me nenin 62 te ligjit nr.110, date 20.12.2018 "Per Noterine", vertetoj nenshkrimin e tyre.

15.3. Ne zbatim te Ligjit nr.9887, date 10.03.2008 "Per mbrojtjen e te dhenave Personale", une Noterja deklaroj se do te ruaj dhe perpunoj te dhenat personale te subjekteve te kesaj kontrate, ne menyre te drejte dhe te ligjshme.

PALET KONTRAKTUESE

SHITËSI

Bashkia Elbasan

Gledian Llatja

i autorizuar nga Asim Sula

NOTER
ORNELA GURANIJKU



BLERËSI

"BLAED TRADE" sh.p.k

Ilir Mustafaj



